

Dr. Ardit BIDO

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

SKEDIMI ELEKTRONIK NË ARKIVIN QENDROR SHTETËROR

Abstrakt: *Një ndër elementet më thelbësore ku përputhet teknologjia dhe arkivistika është përshkrimi elektronik i dokumenteve. Dixhitalizimi nuk është i tillë, por thjesht skanim, nëse nuk ka metadatat e nevojshme që e bëjnë të përshkrueshëm. Ndërkaq, një arkiv pa mjete informimi është i paplotë, pasi nuk kryen detyrën e vet funksionale të orientimit të studiuesit drejt dokumentit që ai kërkon. Rrjedhimisht përshkrimi elektronik i dokumentit mundëson që dixhitalizimi të japë ato mjete informimi që ndihmojnë studiuesin në gjetjen e informacionit që kërkon. AQSH do të nisë këtë proces muajt në vijim, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare ISAD(G) dhe RIC.*

Fjalët kyçe: *Përshkrimi elektronik, metadata, digjitalizim, skedim, arkiv.*

Hyrje

Përshkrimi i dokumenteve është një ndër detyrat më kryesore për një arkiv historik, teksa detajimi i informacionit në nivelin e dokumentit mundëson krijimin e formave të shumëllojshme të mjeteve të informimit, duke lehtësuar punën e studiuesit në gjetjen e shpejtë dhe të saktë të dokumenteve që kërkojnë për një studim të caktuar. Ky proces pune bëhet edhe më i rëndësishëm vitet e fundit, kur arkivistika po evoluon falë ndihmës që jep teknologjia e informacionit, duke bërë që të dhënat e shumta të përshkrimit të dokumenteve të ndërveprojnë lehtësisht duke krijuar mjete dinamike informacioni përmes teknologjisë së informacionit.¹

Pak histori

Arkivi Qendror Shtetëror zotëron sot një sasi të konsiderueshme të mjeteve

¹ Për një qasje praktike mes dixhitalizimit dhe arkivistikës, shih edhe strategjinë dixhitale të Arkivit Kombëtar të Mbretërisë së Bashkuar: Arkivat Kombëtare, *Digjital Strategy* (Londër: National Archives, 2017), <https://www.nationalarchives.gov.uk/documents/the-national-archives-digital-strategy-2017-19.pdf>.

të informacionit në formën e skedave² dhe katalogëve, ndër të cilat katalogë e skedarë sistematikë dhe emërorë, ndërkohë që për periudha të caktuara ka edhe katalogë tematikë, gjeografikë e të tjera. Ky proces punë nisi në vitet 1970, gjatë periudhës së konsolidimit të Arkivit Qendror Shtetëror. Mirëpo, procesi i krijimit të mjeteve të informimit u ndërpre pas viteve 1990, ku krijimi i skedave në mënyrë të organizuar u ndërpre në vitin 1994, ndërsa krijimi sporadik i skedave u ndërpre prej vitit 2009.³

Këto mjete informimi kanë një sërë problematikash. Së pari, ato janë të paplota duke qenë se ky proces punë, i cili në një arkiv historik duhet të jetë i vazhdueshëm, është ndërprerë për thujtse çerek shekulli. Së dyti, të dhënat e kërkuara nga skedat janë të mangëta, ku shumë pak elementë të përshkrimit të dokumentit kanë qenë të parashikuara në formatin e miratuar prej viteve 1970, ndërkohë që standardet e sotshme kërkojnë një sërë të dhënash që mundësojnë ndërveprimin e informacionit për të krijuar mjete sa më të plota informimi. Këto skeda shpesh herë janë përqendruar vetëm në nivelin e njësive së ruajtjes dhe nuk janë skeda mbi dokumentet në vetvete. Për më tepër, të dhënat e kërkuara nga skeda shpesh herë janë plotësuar pjesërisht nga arkivistët që kanë krijuar mjetet e informimit dhe në shumë raste ato janë të ndikuara nga ideologjia e kohës kur janë krijuar, duke mos qenë më të përputhshme me parimet e arkivistikës. Së fundmi, por jo për nga rëndësia, zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe mundësia e ndërveprimit të informacionit të përshkrimit të dokumenteve për të prodhuar mjete informimi të shumëllojshme, praktikisht i kanë bërë skedat tradicionale një formë të tejkualuar, që kërkon të përshtatet me evoluimin e arkivistikës si edhe me standardet ndërkombëtare që janë po ashtu në evoluim.

Skedimi elektronik: Rasti i AQSH

Skedimi elektronik që do të nisë në muajt në vijim në AQSH përmes një sektori të posaçëm prej 10 personash do të jetë i vazhdueshëm si një punë, gjithnjë e në përmirësim, dhe të thelluar që si në çdo arkiv historik, praktikisht nuk përfundon asnjëherë. Ky proces do të bazohet në modelin ekzistues të dixhitalizimit *on demand* (sipas kërkesës), teksa do të përbëjë komponentin përfundimtar të tij. Aktualisht, në DPA skanohen 11701 fletë dokumente çdo ditë, të cilat më pas hidhen në sistemin elektronik në dosjen përkatëse, që është e lidhur me pemën arkivore.⁴ Përshkruesit e sektorit të posaçëm do të nisin përshkrimin e

² Shih figurën 1, për modelin e një skede.

³ Shih Sokol Çunga, “Lënda arkivore përmes mjeteve të kërkimit: përgatitja e instrumenta studiorum si formë evidentimi, shërbimi dhe përmbushjeje e detyrimeve ligjore të arkivave. Rasti i Arkivit Qendror Shtetëror”, *Arkivi Shqiptar* 1-2(2017), fq. 120-125.

⁴ Për dixhitalizimin sipas kërkesës në AQSH, shih edhe: Ardit Bido, “Dixhitalizimi sipas kërkesës: Rasti i AQSH”, *Arkivat Shqiptare* 1-2(2018), fq. 13-18.

dokumenteve për ato dokumente që janë të skanuara, për të përfunduar tërësisht dixhitalizimin e tyre.

Të dhënat e kërkuara për përshkrimin e dokumentit janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, veçanërisht ISAD(G)⁵, e cila përbën bazën e elementeve të kërkuara të përshkrimit edhe për standardin e ri RIC (Records in Context)⁶, që i mëshon ndërveprimit të metadatave (elementeve përshkrimore) për të lehtësuar procesin e kërkimit të dokumentit nga studiuesit.

Kështu, në nivel fondi, dokumentet e kërkuara do të jenë: Numri, Numër i mëparshëm, Titulli, Historiku i fondkrijuesit, Përshkrim i fondkrijuesit, Statusi, Plani i rregullimit, Sasia dhe bartësit, Koha e krijimit, Numri i njërive të ruajtjes, Numri i fletëve, Vendruajtja, Shënime. Në nivelin e njësisë së ruajtjes (dosjes) do të jenë këto metadata: Numri; Numër i mëparshëm; Titulli; Koha e krijimit; Lloji i bartësit; Sasia; Data e përpunimit; Arkivisti përpunues; Shënime. Në nivel dokumenti do të jenë: Përshkrimi; Numri i fletëve; Numri i imazheve; Data e krijimit; Lloji i bartësit; Data e hartimit të përshkrimit; Përshkruesi; Dhuruesi/shitësi/pronarë të mëparshëm; Gjendja fizike e ruajtjes; Periudha kohore; Restaurim; Foto para restaurimit; Proceset e restaurimit; Foto pas restaurimit; Restauratori; Koha e restaurimit; Shënime. Përveç këtyre të dhënave në nivel dokumenti do të jenë edhe përshkruesit (fjalët kyçe) të cilat do të mundësojnë ndërlidhjen e fjalëve kyçe si formë kërkimi për të mundësuar krijimin automatik në format elektronik të mjeteve të informimit për secilën prej të dhënave të përcaktuara në këtë nivel. Përshkruesit do të jenë: Autori; Marrësi; Emra personazhesh; Tematika; Gjuha; Vendbanime; Reliev; Profesioni; Lloji i dokumentit, etj.

Këta përshkrues krijojnë mundësinë e ndërveprimit mes metadatave në atë formë, saqë krijojnë një numër mijëra herë më të madh të mjeteve të mundshme të informimit në krahasim me skedimin tradicional. Kjo vjen në kontrast të plotë me skedat aktuale në AQSH, që përmbajnë vetëm këto të dhëna: fondi, struktura, dosja, inventari, fleta, koha, vendi, gjuha, indeksi, titulli, përpiluesi dhe data e përpilimit. Ky ndërveprim i ri elektronik mundëson ndër të tjera edhe ndërlidhjen e mundshme me arkiva të tjera që ruajnë informacion me ndërvarësi me fondin ose dokumentin përkatës, sipas standardit ende në zhvillim RiC⁷.

⁵ Jusuf Osmani (përg.), *ISAD(G): Standardi i përgjithshëm ndërkombëtar për përshkrimin e lëndës arkivore (botimi i dytë)*,. Shih edhe: Jusuf Osmani, “Metodologjia e përshkrimit të lëndës arkivore sipas standardit të përgjithshëm ndërkombëtar për përshkrimin e lëndës arkivore-ISAD(G)”, *Arkivat Shqiptare* 1-2(2018), fq. 19-36.

⁶ Këshilli Ndërkombëtar i Arkivave, *Records in Context (RiC): An archival description draft standard*, (Seul: ICA, 2016), <https://www.ica.org/sites/default/files/session-7.8-ica-egad-ric-congress2016.pdf>.

⁷ Shih figurën 2.

Përfundime

Arkivi Qendror Shtetëror ka një numër të konsiderueshëm skedash që mundësojnë krijimin e mjeteve të informimit. Mirëpo, ky proces pune nuk ka qenë i saktë dhe i plotë, si dhe është ndërprerë prej një çerekshekulli. Sfidat e reja të arkivistikës mund të tejkalohen përmes teknologjisë së informacionit, duke u bazuar tërësisht në standardet ndërkombëtare të arkivistikës, si ISAD(G) dhe RiC. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave do të rinisë procesin e krijimit të mjeteve të informimit, tashmë përmes përshkrimit elektronik, duke krijuar një databazë gjithnjë e në plotësim përmes përmbylljes së ciklit të punës së “dixhitalizimit sipas kërkesës”. Plotësimi i të dhënave të kërkuara nga standardet ndërkombëtare do të mundësojë krijimin dinamik të mjeteve të informimit përmes ndihmës së teknologjisë së informacionit, duke i ardhur gjithnjë e më shumë në ndihmë studiuesve.

Bibliografi:

- Arkivat Kombëtare. *Digital Strategy*. Londër: National Archives, 2017. <https://www.nationalarchives.gov.uk/documents/the-national-archives-digital-strategy-2017-19.pdf>.
- Bido, Ardit: “Dixhitalizimi sipas kërkesës: Rasti i AQSH”. *Arkivat Shqiptare* 1-2 (2018).
- Çunga, Sokol. “Lënda arkivore përmes mjeteve të kërkimit: përgatitja e instrumenta studiorum si formë evidentimi, shërbimi dhe përmbushjeje e detyrimeve ligjore të arkivave. Rasti i Arkivit Qendror Shtetëror”. *Arkivi Shqiptar* 1-2 (2017).
- Këshilli Ndërkombëtar i Arkivave. *Records in Context (RiC): An archival description draft standard*. Seul: ICA, 2016. <https://www.ica.org/sites/default/files/session-7.8-ica-egad-ric-congress2016.pdf>.
- Osmani, Jusuf, përg. *ISAD(G): Standardi i përgjithshëm ndërkombëtar për përshkrimin e lëndës arkivore (botimi i dytë)*, Prishtinë, 2009.
- Osmani, Jusuf. “Metodologjia e përshkrimit të lëndës arkivore sipas standardit të përgjithshëm ndërkombëtar për përshkrimin e lëndës arkivore-ISAD(G)”. *Arkivat Shqiptare* 1-2(2018).

